



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 3467 Prot.

Koplik, më 14.11, 2025

**V E N D I M**

Nr. 168, Datë 14.11, 2025

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË NJËSISË SË MONITORIMIT  
TË PËRFORMANCES**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**VENDOSI :**

1. Miratimin e “Rregullores së Brendshme të Njesisë së Monitorimit të Përformances”, e cila bashkëlidhet me këtë vendim dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Njësia e Monitorimit, Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat e tjera të Bashkisë të cilat preken nga ky vendim.

Faleminderit për mirëkuptimin !





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
NJËSIA PERFORMANCES

Nr. 3461 Prot

Nr. \_\_\_ datë 14.11.2025

RREGULLORE E BRENDSHME E NJËSISË SË  
MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

KREU I  
TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
Të përgjithshme

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rolit (përgjegjësi) të Njesisë së Monitorimit të Performancës, procedurave, afateve dhe formateve të raportimit që duhet të ndiqen nga bashkia për përgatitjen e raportit vjetor të performancës, raporteve të ndryshme sipas kërkesave të bashkisë dhe Këshillit bashkiak apo institucioneve qendrore.
2. Kjo rregullore azhurnohet në vijim të ndryshimeve të kuadrit ligjor por edhe të politikave të ndryshme që ndërmerr bashkia duke reflektuar mbështetjen që Njësia e Monitorimit të Performancës i shërben atyre.
3. Në këtë rregullore përcaktohen:
  - a. Përgjegjësitë e Kryetarit të bashkisë;
  - b. Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm
  - c. Përgjegjësitë e Njesisë së Monitorimit të Performancës .
  - d. Komunikimi me struktura të tjera të bashkisë (brenda saj apo në varësi të saj) dhe jashtë bashkisë (qeverisja qendrore, agjenci qeveritare, ente rregullatore, etj)
  - e. Afatet e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, analizimit, hartimit, miratimit dhe publikimit të të dhënave për Raportin Kombëtar të Performancës dhe të Raportit vjetor të performancës së Bashkisë;
  - f. Struktura dhe përmbajtja e formateve të mbledhjes së të dhënave, Regjistrin të të dhënave të shërbimeve, dhe raportit vjetor të performancës së bashkisë;
4. Raportimi i bashkisë si pjesë e Raportit Kombëtar të Performancës së Bashkive pranë AMVV bëhet pjesë e një ushtrimi kombëtar që Qeveria bën për të kuptuar se si është situata me bashkitë dhe sesi po ecin ato në realizimin e funksioneve të tyre. Bashkia ka detyrimin të plotësojë kërkesat për raportim sipas afateve dhe formateve të kërkuara.

Bashkia në realizimin e kësaj kërkesë raportimi ndjek udhëzimin e marrë nga AMVV që shpjegon procesin dhe pasaportën e tregusve të performancës dhe të dhënat bazë të llogaritjes së tyre në mënyrë të detajuar.

5. Raporti vjetor i performancës së shërbimeve të bashkisë ka për qëllim:
  - a. Të ndjekë arritjen e qëllimit dhe objektivave të shërbimeve nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me rezultatet faktike të tyre, si dhe krahasimit të trendit të tyre me vitet paraardhëse.
  - b. Të sigurojë informacion, i cili i shërben përmirësimit të ofrimit të shërbimeve bazuar në performancë.
  - c. Të evidentojë nëse realizimi i objektivave është në përputhje me synimet e përcaktuara dhe të mbështesë procesin e vendimmarrjes për realizimin e tyre.

## **Neni 2**

### **Strukturat përgjegjëse për hartimin e raportit vjetor të performancës së shërbimeve**

1. Strukturat e njësisë së vetëqeverisjes vendore që marrin pjesë në procesin e hartimit të raportit vjetor të performancës së shërbimeve janë:
  - a. Kryetari i bashkisë;
  - b. Sekretari i Përgjithshëm;
  - c. Njësia e Monitorimit të Performancës .
  - d. Njësitë e ofrimit të shërbimeve në strukturën organike të bashkisë;
  - e. Njësitë që ofrojnë shërbime mbështetëse në strukturën organike të bashkisë;
  - f. Drejtoria përgjegjëse për financën dhe buxhetin;
  - g. Institucionet e varësisë të bashkisë;
  - h. Njësi të tjera të bashkisë që janë burimi primar i matjes dhe raportimit të të dhënave që shërbejnë për raportin vjetor të performancës së shërbimeve.

## **KREU II**

### **PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E RAPORTIMIT VJETOR TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE**

## **Neni 3**

### **Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë**

1. Miraton dhe dërgon zyrtarisht raportimin e performancës së bashkisë si pjesë e raportit të performancës në nivel Kombëtar sipas kërkesës zyrtare të AMVV
  - a. Merr nga Sekretari i Përgjithshëm listën e plotësuar të të dhënave dhe TP pjesë e sistemit të PMS-it
  - b. Miraton listën e të dhënave dhe TP dhe e dërgon zyrtarisht pranë AMVV

- c. Bën objeksione në lidhje me të dhëna të publikuara nga AMVV në Raportin Kombëtar të performances, kur ato janë të ndryshme nga ajo çfarë ka raportuar zyrtarisht bashkia pranë AMVV-së
2. Miraton dhe dërgon zyrtarisht aplikimin për Grantin me Bazë Performance (GBP) sipas shpalljes zyrtare të AMVV-së
  - a. Merr nga Sekretari i Përgjithshëm listën e plotësuar të të dhënave dhe TP pjesë e kërkesës së GBP
  - b. Miraton listën e të dhënave dhe TP dhe e dërgon zyrtarisht pranë AMVV
  - c. Bën objeksione në lidhje me të dhëna të publikuara nga AMVV në në kuadrin e procesit të aplikimit për Grant me Bazë Performance, kur ato janë të ndryshme nga ajo çfarë ka raportuar zyrtarisht bashkia pranë AMVV
3. Kryetari i bashkisë miraton, nënshkruan dhe dërgon për informim në këshillin bashkiak Raportin vjetor të performancës së bashkisë.

#### **Neni 4**

##### **Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm**

1. Merr nga Njësia e Monitorimit të Performancës raportimin e performancës së bashkisë si pjesë e Raportit të Performancës në nivel Kombëtar dhe aplikimin për GBP sipas kërkesës zyrtare të AMVV dhe ia dërgon për miratim Kryetarit të bashkisë
  - a. Listën e plotësuar të të dhënave dhe TP sipas formatit të kërkesës së AMVV
  - b. Raportimin për nivelin Kombëtar e bën pjesë edhe të Raportit Vjetor të Performancës së Bashkisë
  - c. Aplikimin për GBP me gjithë të dhënat dhe TP dokumentacionin mbështetës sipas formatit të shpallur nga AMVV
  - d. Raportin e performancës së bashkisë
2. Vlerëson raportin vjetor të performancës së bashkisë. Konkretisht, Sekretari i Përgjithshëm, rishikon raportin vjetor të performancës së bashkisë dhe vlerëson realizimin e objektivave të planifikuar për arritjen e qëllimit të shërbimeve që ofron bashkia.
3. Vlerëson aplikimi për GBP dhe dokumentacionin mbështetës të tij sipas formateve të shpallura nga AMVV dhe afateve të përcaktuara nga kjo e fundit.
4. Njofton kryetarin e bashkisë që ka oponencë në lidhje me të dhënat e shpallura, publikuara nga AMVV në lidhje me raportin kombëtar të performancës apo të dhënave të shpallura për GBP.
5. Sekretari i përgjithshëm i ndihmuar nga Komisioni i Performancës në Komisionet e Këshillit të Bashkisë dhe në Këshillin e Bashkisë Raportin Vjetor të Performancës së bashkisë. Sipas nevojës, në prezantim mund të përfshihen edhe drejtuesit e njësive të shërbimeve përkatëse.
6. Koordinon takime në lidhje me performancën e bashkisë midis strukturave / Njësive të ndryshme brenda apo jashtë bashkisë nëse kjo është kërkuar nga Njësia e posaçme e Monitorimit të Performancës .

## Neni 5

### Përgjegjësitë e Njësive në bashki

1. Të gjitha Njësitet bashkëpunojnë me Njësien e Monitorimit të Performancës për përgatitjen e Raportit vjetor të performancës së shërbimeve të bashkisë. Njësitet i japin vëmendje të vecantë në cilësinë e përgatitjes dhe respektimin e afateve në lidhje me raportimin e Performancës së Bashkisë për Nivelin Kombëtar / AMVV.
2. Plotësimi i të dhënave të kërkuara nga Njësia e Performancës bëhet duke ndjekur Manualin e Matjes së Performancës së Bashkive (i përgatitur dhe ndarë me bashkitë nga AMVV) dhe koordinuar ngushtësisht me këtë sektor për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe respektimin e afateve.
3. Njësitet janë përgjegjëse për plotësimin me të dhëna të sakta të skedës së performancës së shërbimeve (Shtojca 2) duke përdorur metoda të njohura/pranuara.
4. Njësitet mund të ndryshojnë përmbajtjen e Skedës së të dhënave të shërbimit, duke:
  - a. Shtuar të dhëna të tjera të shërbimeve që nuk përmbahen në skedë
  - b. Hequr të dhëna që nuk i përkasin shërbimit që ofrojnë
  - c. Korigjuar vlerat e të dhënave që ndodhen në skedë në rast se konstatohet që janë të pasakta.
5. Për çdo ndryshim në skedën e performancës së shërbimit Njësitet duhet të informojnë Njësien e Monitorimit të Performancës.
6. Njësitet nuk mund të heqin nga skeda e performancës së shërbimit të dhëna që i përkasin kategorive SMP (Sistemi i Matjes së Performancës).
7. Të dhënat që i takojnë kategorive SMP janë të detyrueshme për t'u plotësuar.
8. Në rast se Njësitet nuk plotësojnë ndonjë nga të dhënat e përcaktuara në skedën e performancës së shërbimeve, duhet të paraqesin me shkrim arsyet objektive që i kanë penguar në plotësimin e tyre dhe të marrin masa për zgjidhjen e problematikave që kanë ndeshur.
9. Njësitet dërgojnë tek Njësia e Performancës Skedën e Performancës së Shërbimeve të plotësuar dhe nënshkruar nga drejtuesi i njësisë brenda afateve kohore të përcaktuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
10. Njësitet kanë të drejtë të pajisen nga Njësia e Monitorimit të Performancës me një kopje të të dhënave dhe treguesve të performancës së shërbimit të tyre nga Regjistri i të dhënave të shërbimeve që administrohet nga Njësia e Performancës.
11. Njësitet kanë të drejtë të kërkojnë:
  - a. Ndryshimin e vlerave të të dhënave në regjistër në rast se konstatohet se janë të pasakta.
  - b. Përfshirjen në regjistër të të dhënave të shërbimit që mungojnë.
  - c. Përfshirjen në regjistër të treguesve të performancës së shërbimit që mungojnë.

- d. Heqjen nga regjistri të të dhënave që nuk i përkasin shërbimit të tyre.
12. Çdo kërkesë e përcaktuar në pikën 10 duhet të përmbajë argumentimin përkatës dhe t'i dërgohet KP-së në formë zyrtare.
  13. Njësitë njihen me Draft Raportin vjetor të performancës së bashkisë të përgatitur nga Njësia e Monitorimit të Performancës dhe paraqesin komentet, sugjerimet apo kërkesat e tyre për ndryshim, brenda afateve të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
  14. Njësitë përdorin raportin vjetor të performancës së shërbimeve, që i vihen në dispozicion nga Njësia e Monitorimit të Performancës për të analizuar shërbimin e ofruar dhe për të ndër marrë vendime të informuara për përmirësimin e shërbimit.
  15. Njësitë marrin pjesë në takimet e organizuara nga Njësia e Monitorimit të Performancës për të diskutuar mbi çështje që lidhen me të dhënat, treguesit e performancës dhe raportin vjetor të performancës së bashkisë.

## **Neni 6**

### **Përgjegjësitë e Drejtuesit të Njesisë përgjegjës për Financën dhe Buxhetin në bashki**

1. Drejtuesi i Njesisë përgjegjëse për Financën dhe Buxhetin (më tej Financa) është përgjegjës dhe i dërgon Njësia e Monitorimit të Performancës informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raportit vjetor të performancës së bashkisë sipas afateve të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.
2. Raportimi i të dhënave financiare bëhet sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje dhe përmban informacion mbi të ardhurat, shpenzimet dhe investimet për:
  - a. Planin dhe faktin e vitit të raportimit (viti *t*)
  - b. Faktin e dy viteve paraardhëse të raportimit (vitet *t-2*, *t-1*)
3. Financa përdor të dhënat dhe treguesit e performancës që i dërgon Njësia e Monitorimit të Performancës për të plotësuar anekset përkatëse të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin e raportimit.
4. Në rast se Financa nuk plotëson ndonjë nga të dhënat e përcaktuara në Shtojcën 2, duhet të paraqesë me shkrim arsyet objektive që e kanë penguar në plotësimin e tyre dhe të marrë masa për zgjidhjen e problematikave që ka ndeshur.
5. Financa i dërgon Njësia e Monitorimit të Performancës Shtojcën 2 të plotësuar dhe nënshkruar nga drejtuesi i njesisë brenda afateve kohore të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.
6. Financa njihet me Draft Raportin vjetor të performancës së bashkisë të përgatitur nga Njësia e Monitorimit të Performancës dhe paraqet komente, sugjerime apo kërkesë për ndryshim, brenda afateve të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

7. Financa merr pjesë në takimet e organizuara nga Njësia e Monitorimit të Performancës për të diskutuar mbi çështje që lidhen me të dhënat financiare, treguesit kyç financiar dhe raportin vjetor të performancës së bashkisë.

## Neni 7

### Përgjegjësitë e Njesisë së Monitorimit të Përformances

1. Siguron informacion të thjeshtë dhe të mirë-strukturuar me qëllim që të ndihmojë vendimarrjen e Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak dhe drejtuesve të strukturave bashkiake përgjegjëse për politikën dhe realizimin e cdo funksioni/shërbimi publik, nëpërmjet mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të përgatitjes raporteve të performancës.
2. Mbledh, përditëson, kontrollon dhe publikon të dhëna teknike dhe financiare në lidhje me performancën e bashkisë, duke siguruar cilësi të të dhënave;
3. Koordinon procesin e mbledhjes së këtyre të dhënave me strukturat bashkiake përgjegjëse për politikën, mbikqyrjen dhe /apo realizimin e funksionit/shërbimit publik përkatës (në vijim “strukturat përgjegjëse specifike”).
4. Miraton dhe shpërndan formate standarte për mbledhjen e të dhënave teknike për matjen e treguesve ( ndryshe “pasaporta e të dhënave”).
5. Ofron përkufizime për të dhënat e sistemit të monitorimit të performancës që përdor bashkia;
6. Sugjeron metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave si edhe verifikimit të cilësisë së të dhënave të mbledhura dhe raportuara;
7. Ruan, mirëmban dhe administron bazën e të dhënave me të dhënat teknike të shërbimeve/funksioneve të bashkisë dhe treguesve të performancës
8. Sugjeron treguesit e monitorimit të performancës të cilët miratohen nga drejtuesit e strukturat përgjegjëse specifike dhe përcillen në mënyrë periodike tek njësia e monitorimit të performancës së bashkisë;
9. Siguron përditësimin e gjithë sistemit të treguesve të performancës periodikisht, por jo më pak sesa një herë në vit;
10. Garanton cilësinë e të dhënave të mbledhura duke krijuar procese të verifikimit që krahasojnë të dhënat e raportuara me nivelin faktik / realitetin;
11. Analizon të dhënat që synojnë të monitorojnë performancën e bashkisë dhe prodhon raporte duke u fokusuar më së shumti në dy produkte standarte.
12. Përgatit raporte të ndryshme sipas nevojës së Kryetarit, Këshillit Bashkiak; komunikimit me publikun apo kërkesave nga institucionet e qeverisjes qendrore;
13. Ndihmon në monitorimin e planit të përgjithshëm vendor me anë të treguesve të performancës që ndihmojnë në këtë proces;
14. Ndërvepron me dhe asiston njësinë përgjegjëse për buxhetin dhe strukturat përgjegjëse specifike gjatë procesit të hartimit të projekt buxhetit afatmesëm dhe monitorimit të ekzekutimit të buxhetit me të dhëna teknike

15. Mbështet procesin e konsultimit të dokumentave strategjikë dhe programit buxhetor vjetor apo afatmesëm me aktorët e interesit.
16. Njësia e Performancës, në mënyrë të vecantë, përgatit draftet e integruara të Raporteve vjetore të performancës, dhe cdo lloj informacioni që kërkohet në bazë të një kërkesë specifike nga publiku, Këshilli Bashkiak, institucione të qeverisjes qendrore, etj.

### **KREU III**

#### **PROCEDURAT PËR PROCESIN E RAPORTIMIT TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE**

##### **Neni 8**

##### **Përcaktimi i periudhës së raportimit**

1. Raportimi i referohet vitit të fundit buxhetor të mbyllur (t).
2. Në raportim për efekt statistikor dhe mundësi krahasimi dhe nxjerrjesh në pah të trendeve të TP ndër vite raportohen përvec vitit të fundit buxhetor të mbyllur edhe dy vite të mëparshme (t-1) dhe (t-2).
3. Njësia e Performancës fillojnë përgatitjen e raportit vjetor të performancës së bashkisë sipas formateve, afateve dhe standardeve të përcaktuara në këtë rregullore.
4. Kryetari i Njesisë së Performancës, me qëllim sigurimin e të dhënave duhet të koordinojë punën me stukturat burimore të të dhënave sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për mbledhjen, përpunimin, analizën dhe publikimin e raportit.

### **KREU IV**

#### **KOMUNIKIMI ME STRUKTURA TË TJERA**

##### **Neni 9**

##### **Komunikimi me struktura brenda bashkisë**

1. Njësia e Performancës mbledh të dhëna nga burime parësore dhe dytësore, të cilat janë pjesë e strukturave të bashkisë ose në varësi të saj. Kjo Njësi gjithashtu ofron të dhëna për të gjitha strukturat brenda dhe në varësi të bashkisë kur ato janë pjesë e databazës së Performancës së Bashkisë.
2. Struktura burimore të të dhënave janë të gjitha drejtoritë teknike brenda bashkisë (pjesë e aparatit të bashkisë) si: drejtoria e burimeve njerëzore, buxhetit dhe financës, shërbimet mbështetëse, arsimit, drejtoria e zhvillimit ekonomik, drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, drejtoria e bujqësisë, turizmit etj.
3. Struktura burimore të të dhënave në varësi të bashkisë janë të gjitha ato struktura, agjenci që varen nga bashkia dhe që krijojnë të dhëna të cilat janë të nevojshme për të hartuar dokumenta periodik apo specifik nga Njësia e Performancës si edhe pjesë e SMP. Struktura

burimore në varësi të bashkis të tilla si: qendra e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi; inspektoriati vendor për mbrojtjen e territorit; qendrat kulturore dhe sportive; policia bashkiake; inspektoriati vendor për mbrojtjen e territorit; cerdhet, kopshtet dhe konviktet; qendrat sociale; tatimet dhe taksat vendore; gjendja civile; njësia e menaxhimit të tokave bujqësore dhe kullotave- pyjeve; mbrojtja civile etj.

4. Komunikimi kryhet nëpërmjet Kryetari i Njesisë së Performancës për grumbullimin e të dhënave nga strukturat teknike brenda bashkisë. Për grumbullimin e të dhënave që janë burim i strukturave të varësisë së bashkisë, komunikimi kryhet nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm.

#### **Neni 10**

##### **Komunikimi me struktura jashtë bashkisë**

1. Njësia e Performancës mbledh të dhëna edhe nga struktura burimore të të dhënave jashtë bashkisë të cilat janë të nevojshme për të hartuar dokumenta periodik apo specifik të tilla si: instituti i statistikave zyrtare (INSTAT); zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP); Enti Rregullator i Ujit të Pijshëm dhe Kanalizimeve (ERRU); etj; si edhe cdo institucion tjetër i pavarur apo në varësi të qeverisë.
2. Komunikimi për sigurimin e të dhënave nga këto struktura kryhet nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë.

#### **KREU V**

#### **PRODUKTET E NJËSISË SË PERFORMANCËS**

##### **Neni 11**

##### **Produktet e Njesisë së Performancës**

1. Bashkia përgatit, ndan dhe diskuton, paraqet në Këshillin Bashkiak dhe publikon raporte periodike dhe dokumenta të tjerë sipas nevojës së bashkisë apo institucioneve të tjera me kërkesë pranë Kryetarit të Bashkisë.
2. Raportet periodike janë: Raporti vjetor i performancës së bashkisë; Raporti Kombëtar i Performancës; Buxheti Vjetor dhe Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë.
3. Dokumenta apo Raporte specifike janë ato dokumenta të cilat realizohen sipas kërkesës së Kryetarit të Bashkisë, Sekretarit të Përgjithshëm, Këshillit Bashkiak apo cdo institucioni tjetër brenda apo jashtë bashkisë. Gjithësesi realizimi i cdo dokumenti apo raporti tjetër specifik bëhet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm i cili jep udhëzime për përmbajtjen e tij, afateve dhe përmbajtjes.
4. Për përgatitjen e raporteve periodike të tilla si: Raporti vjetor i performancës së bashkisë dhe Raporti kombëtar i performancës Njësia e Performancës ka përgjegjësinë e plotë të realizimit të tyre, duke respektuar formatet, afatet dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe komunikimit sikurse përcaktohet në Shtojcat e kësaj Rregulloreje.

5. Për përgatitjen e raporteve periodike si: Buxheti vjetor dhe PBA Njësia e Performancës është kontribues në proces me anë të të dhënave të performancës shprehur në Tregues Performance për programet buxhetore që përdor bashkia. Përgjegjësia për udhëheqjen e këtij procesi dhe përfundimin e këtyre dokumentave është ashtu sikurse përcaktohet në Udhëzimin vjetor të përgatitjes së Buxhetit dhe PBA-së së bashkisë.
6. Në përgatitjen e dokumentave apo raporteve specifike si për shembull: Plani i Menaxhimit të Integruar të mbetjeve; Plani i zhvillimit urban dhe i territorit; Plani Social etj., Njësia e Performancës mbështet me të dhëna të nevojshme për hartimin e këtyre dokumentave nëse ato janë pjesë e databazës së Performancës. Formatet, afatet dhe procesi përcaktohet nga Struktura Teknike që udhëheq hartimin e dokumentit specifik në fjalë.

## **KREU VI TË TJERA**

### **Neni 12 Të tjera**

1. Procedura të tjera shtesë lidhur me procesin e raportimit të performancës së bashkisë, jepen në shtojcat bashkëlidhur kësaj rregulloreje, përkatësisht:
  - a. Shtojca 1 “Afatet kohore për raportimin e performancës së bashkisë”
  - b. Shtojca 2 “Formati Standard i Skedës së performancës së bashkisë”
  - c. Shtojca 3 “Formati i të dhënave financiare”
  - d. Shtojca 4 “Përmbajtja e regjistrit të të dhënave të shërbimeve”
  - e. Shtojca 5 “Përmbajtja e Raportit Vjetor të Performancës së bashkisë”
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë



## **Shtojca 1: Afatet Kohore për Raportimi e Performancës së Bashkisë**

Në mënyrë të përmbledhur i gjithë procesi i raportimit të performancës së bashkisë/ në nivel kombëtar ose ndryshe SMP, me afatet kohore, Njësiti përgjegjës dhe dokumentat e prodhuar jepet në tabelën e mëposhtme:

Proçesi për raportimin e performancës së bashkive nis me kërkesën zyrtare të Agjencisë për Mbështjetjen e VetëQeverisjes Vendore (AMVV) që i drejtohet të gjitha NJVQV-ve. Në këtë kërkesë, ndër të tjera, AMVV përcakton treguesit e performancës (TP) që duhet të raportohen nga NJVQV-të, formatin e raportimit të treguesve si dhe afatin kohor të raportimit.

Me marrjen e kësaj kërkesë, Kryetar i Bashkisë inicjon procesin e mbledhjes së të dhënave përmes një urdhri të brendshëm për raportimin e vitit përkatës.

Në zbatim të urdhërit vjetor të kryetarit, Kryetari i Njesisë së Monitorimit shpërndan tek të gjitha njësiti teknike të bashkisë skedën përkatëse të raportimit të performancës së shërbimit. Në varësi dhe të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) që ka në dispozicion bashkia, skeda mund të shpërndahet elektronikisht ose në format letër. Njësia e Monitorimit Performancës, sipas afateve të përcaktuara, mbledh skedat e performancës së shërbimit të plotësuar dhe sigluara nga drejtuesit e njësive të shërbimeve përkatëse, bën kontrollin e plotësimit të të dhënave dhe, sipas mundësisë, verifikimin e cilësisë së tyre. Gjatë këtij procesi ndërvepron sipas nevojës me njësiti përkatëse, apo ekspertë të shërbimit.

**Njësia e Performancën regjistron të dhënat e mbledhura përmes skedave në regjistrin e performancës së shërbimeve, në faqet përkatëse. Përpilon një file / dokument përmbledhës për të gjitha të dhënat dhe treguesit e performancës.** Në regjistrin e performancës së shërbimeve, të gjithë treguesit e performancës përlllogariten automatikisht sipas formulave të paracaktuara, në përputhje me formulën e përcaktuar në pasaportën e treguesit.

Kryetari Njesisë së Performancës përgatit materialin përfundimtar të kërkuar për raportim nga AMVV, sipas formatit të përcaktuar në kërkesë, dhe ia dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë për konfirmim dhe më tej për miratim tek Kryetari i Bashkisë. Materiali i miratur dërgohet tek AMVV brenda afatit të përcaktuar si edhe për Raportin e Plotë të Performancës vendore për t'u paraqitur në Këshillin Bashkiak i cili duhet ti shërbejë përgatitjes së PBA-së.

Në mënyrë të përmbledhur i gjithë procesi i raportimit të performancës së bashkisë si edhe atij Kombëtar / SMP, njësiti përgjegjës dhe materialet e prodhuar jepen në skemën e mëposhtme:

|   |  |  |
|---|--|--|
| I. AMVV   | <ul style="list-style-type: none"> <li>Dërgon kërkesën për raportimin vijtor tek të gjitha bashkitë (bashkelidhur edhe manualin)</li> </ul> <p>Kjo kërkesë përmban Qellimin, Listën e KPIs pjesë e SMP dhe të dhënat përkatëse të kërkuara, afatet kur bashkitë duhet të dërgojnë raportin kombëtar të performancës së tyre, dhe se si duhet ta përgatisin këtë raport duke i bashkëngjitur manualin përkatës.</p> | Për t'u caktuar nga AMVV   |
| II Kryetari i Bashkisë / Sekretari Përgjithshëm | <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxjerr urdhër të brendshëm për raportimin vijtor kombëtar të performancës së bashkisë tek AMVV / niveli kombëtar</li> </ul>   | +2 ditë max nga afati i AMVV   |
| III Shefi i tëPerformancës                      | <ul style="list-style-type: none"> <li>Dërgon në formë zyrtare Skedat e Performancës së shërbimeve tek Njësitë e shërbimeve dhe tek Financa për plotësim nga ana e tyre.</li> <li>Paraprakisht identifikon ato skeda / ato të dhëna që janë urgjente për raportimin e performances tek AMVV / niveli kombëtar</li> </ul>   | +2 ditë max nga Urdhëri i Kryetarit / Sekretarit të Përgjithshëm   |
| IV AMMV   | <ul style="list-style-type: none"> <li>Organizon trajnime ne lidhje me matjen e performances së bashkive</li> <li>me mbështetjen e projektit “Bashki te Forta”</li> </ul>  | +5 ditë max fillojnë scanat nga data e shkrësës zyrtare të AMVV  |
| V Njësitë teknike shërbimeve                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledhin të dhënat e shërbimeve dhe financës si edhe plotësojnë Skedat e Performancës së shërbimeve përkatëse</li> <li>Dërgojnë zyrtarisht Skedat e plotësuara dhe të firmosura tek KP</li> </ul> <p>- Departamentet</p> <p>- Drejtoritë</p> <p>- Sektorët përgjegjës</p> <p>- Financa</p>  | 1 javë kohëpër të dhënat e raportimit per raportimin kombëtar (SMP) <p>1 muaj kohë ( për gjithë të dhënat tjera)</p> |

**Hapi Përgjegjës****Aktiviteti****Afati**

| Hapi Përgjegjës | Aktiviteti  | Afati   |
|-----------------|---|---|
| VI              | <b>Kryetari i Njësisë të Performancës Monitorimit të Performancës</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Mbledh dhe verifikon plotësimin e skedave të performancës së shërbimeve;</li><li>Verifikon, sipas mundësisve, saktësinë e të dhënave të raportuara, duke përdorur pasaportën e të dhënave</li><li>Ndërvepron me Njësitë për plotësimin e mangësisve (nëse ka) dhe rregullimin e saktësisë së të dhënave (nëse del nevoja)</li></ul>   | <b>5 ditë nga afati i fundit i dërgimit të të dhënave nga Njësitë</b> (të dhënat për raportim në nivel kombëtar)<br><b>5 ditë nga afati i fundit i dërgimit të të dhënave të tjera</b> (të gjithë dhënat e tjera për raportimin e performancës në nivel vendor)   |
| VII             | <b>Anëtarët e Njësisë së Performancës</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Regjistrin të dhënat në:<ul style="list-style-type: none"><li>File përmbledhës për raportimin në nivel kombëtar / SMP</li><li>Përgatit materialin përfundimtar të kerkuar për raportim nga AMVV – (print file përmbledhës)</li><li>Dergon materialin përfundimtar për miratim te Shefi i Sektorit për miratim/raportim për performancën e bashkise në nivel kombëtar</li></ul></li><li>Regjistrin e madhë të të dhënave të shërbimeve</li></ul> | <b>+2ditë nga Hapi VI</b> (të dhënat për raportin kombëtar të performancës së bashkisë / SMP)<br><b>+ 1 javë nga Hapi VI</b><br><b>+ 1 ditë nga afati pararendës</b><br><b>+ 10 ditë nga afati i Hapit VI në lidhje me këtë detyrë</b> (të gjithë dhënat e tjera për raportin vendor të performancës së bashkisë)<br><b>Brenda afatit të përcaktuar nga AMVV</b><br>(Raporti kombëtar i performancës së bashkisë / SMP) |
| VIII            | <b>Kryetari i Bashkisë</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Miraton dhe dërgon:<ul style="list-style-type: none"><li>Raportin e performancës së bashkive për raportin kombëtar / SMP tek AMVV</li><li>Raportin vendor të performancës së bashkisë për shqyrtim në Këshillin Bashkiak;</li></ul></li><li>Raporti vendor përfshin të dhënat dhe indikatorët e raportimit kombëtar plus të dhënat dhe indikatorët e performancës së detajuar të shërbimeve të bashkisë</li></ul>  | <b>+ 1 muaj nga mbledhja e të dhënave</b> (Raporti vendor i performancës së bashkisë)<br><b>Afati i përcaktuar nga AMVV për dorëzimin e të dhënave</b><br><b>+ 1 javë nga afati i dorëzimit</b>   |
| IX              | <b>AMVV</b> <ul style="list-style-type: none"><li>Analizon dhe përgatit raportin kombëtar të performancës së bashkive;</li></ul>  |   |

|    |   |
|----|---|
|    | <ul style="list-style-type: none"><li>• Prezanton raportin kombëtar dhe e diskuton në mbledhjen e Këshillit konsultativ; + 1 muaj nga afati i dorëzimit</li><li>• Publikon raportin kombëtar të performancës së bashkive dhe e prezanton në një takim/konferencë kombëtare; + 1 javë nga prezantimi në KK</li><li>• Komisionet dikutojnë Raportin vendor të performancës së bashkisë sipas fushës së veprimit/ përgjegjësise së shërbimeve dhe kalendarit të miratuar; Sipas përcaktimit në urdhërin e KB</li><li>- Sekretari harton kalendarin e mbledhjeve të Komisioneve</li><li>- Mbledhja e komisioneve</li></ul>  |
| X  | <p><b>Këshilli Bashkiak (KB)</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kryetari prezanton Raportin vendor të performancës së bashkisë në mbledhje KB. <b>Brenda datës 1 Qershor 2024</b>(për ti paraprirë dorëzimit të dokumentit të PBA-së)</li><li>(Raporti vendor i performancës diskutohet në mbledhjen e keshillit, shënohen rekomandimet për përmirsim në planifikimin e PBA dhe rialokimet e mundshme gjate vitit. Ky proces është në harmonizim me kalendarin për hartimin e PBA, pasi brenda datës 1 qershor Këshilli bashkiak duhet të miratojë draft I-rë PBA),</li><li>• Publikimi i Raportit vendor të performancës së bashkisë në <b>5 Qershor</b> faqen zyrtare web;</li></ul> |
| XI | <p><b>KP</b></p>  |



## Të dhënat e përgjithshme të Bashkisë

Kujtojmë që vietet në kokën e tabelës shihen djathtas njëri pas tjetrit

### LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

| KODI | E DHËNA  | PËRSHKRIMI   | NJËSIA MATËSE | FAKT |     | VLERA |   |
|------|--|--|---------------|------|-----|-------|---|
|      |  |  |               | t-n  | t-2 | t-1   | t |
| 341  | Numri i përgjithshëm i popullsisë në bashki                                  | Numri i popullsisë në territorin e bashkisë  | numër         |      |     |       |   |
| 759  | Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç rezident në territorin e bashkisë      | Kjo e dhënë i referohet numrit total të fëmijëve të moshës 3, 4, 5 dhe 6 vjeç që janë banorë rezident të bashkisë  | numër         |      |     |       |   |
| 469  | Sipërfaqja e tokës bujqësore (në Ha)   | Sipërfaqja e tokës që figuron si tokë bujqësore në regjistrat kadastralë të shtetit, e zënë me bimët e arave, pemshitet, vreshtat dhe ullishtat, brenda kufijve administrative të bashkisë dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë | ha            |      |     |       |   |
| 349  | Numri total i punonjësve të bashkisë   | Numri total i punonjësve të bashkisë. Në këtë numër përfshihet administrata e bashkisë dhe të gjitha strukturat në varësi të saj (njësi shpenzuese) buxheti i të cilave konsolidohet brenda buxhetit të bashkisë.                        | numër         |      |     |       |   |
| 1132 | Numri total i familjeve të bashkisë  | Numri total i familjeve të bashkisë në qytet dhe në zonën rurale (fishatat).   | numër         |      |     |       |   |
| 324  | Numri total i bizneseve aktive në bashkisë                                   | Numri total i bizneseve të regjistruar në Qendërën kombëtare të biznesit që kanë rezidencën e aktivitetit të tyre në territorin e bashkisë me status aktiv   | numër         |      |     |       |   |
| 273  | Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj - 3 vjeç rezident në territorin e bashkisë | Kjo e dhënë i referohet numrit total të fëmijëve të moshës nga 6 muaj deri në 3 vjeç që janë banorë rezident të bashkisë   | numër         |      |     |       |   |

## Të dhënat e Shërbimeve(pjesë e SMP)

| <b>LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E MIRË ADMINISTRIMIT</b> |  |   |                   |                      |             |     |     |              |  |
|---|--|---|-------------------|----------------------|-------------|-----|-----|--------------|--|
| <b>KODI</b>   | <b>E DHËNA</b>   | <b>PËRSHKRIMI</b>   | <b>SHËRBIMI</b>   | <b>NJËSIA MATËSE</b> | <b>FAKT</b> |     |     | <b>VLERA</b> |  |
|   |  |   |                   |                      | t-n         | t-2 | t-1 | t            |  |
| 932   | Numri total i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur nga puna brenda vitit | Numri total i punonjësve të bashkisë që janë larguar nga puna pavarësisht arsyes: largim me dëshirë ose jo, dalje në pension, shkurtim strukture etj. Në këtë numër përfshihet administrata e bashkisë dhe të gjitha strukturat në varësi të saj (njësi shpenzuese) buxheti i të cilave konsolidohet brenda buxhetit të bashkisë. | Burimet njerëzore | numër                |             |     |     |              |  |
| 352   | Numri total i punonjësve të trajnuar                                       | Numri total i punonjësve të bashkisë të trajnuar brenda vitit. Konsiderohen të gjithë punonjësit e trajnuar si pjesë e administratës së bashkisë dhe institucioneve të varësisë (njësive shpenzuese) të saj.  | Burimet njerëzore | numër                |             |     |     |              |  |
| 748   | Numri total i punonjësve të administratës                                  | Numri total i punonjësve të administratës. Pjesë e strukturës së administratës së bashkisë jo institucioneve në varësi të saj   | Burimet njerëzore | numër                |             |     |     |              |  |
| 8   | Numri total i punonjësve në njësitë shpenzuese                             | Numri total i punonjësve në njësitë shpenzuese të cilat janë institucione në varësi të bashkisë, buxheti i të cilave miratohet nga bashkia.   | Burimet njerëzore | numër                |             |     |     |              |  |
| 80  | Numri total i punonjësve në shërbimet e nënkontraktuara të bashkisë        | Numri total i punonjësve në shërbimet e nënkontraktuara të bashkisë si psh: menaxhimi i mbetjeve; mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta dhe riktifjuese – nëse këto janë nënkontraktuar me kontratë shërbimi tek kompani private nga ana e bashkisë   | Burimet njerëzore | numër                |             |     |     |              |  |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E MENAXHIMIT FINANCIAR**

| KODI | E DHËNA  | PËRSHKRIMI  | SHËRBIMI    | NJËSIA<br>MATËSE | FAKT |     | VLERA |   |
|------|--|---|-------------|------------------|------|-----|-------|---|
|      |  |   |             |                  | t-n  | t-2 | t-1   | t |
| 508  | Totali i shpenzimeve të përgjithshme të bashkisë (realizimi faktik vjetor) | Totali i shpenzimeve të bashkisë nga të gjitha burimet e financimit: të ardhurat e veta; hua; granti pakushtëzuar; transferata specifike; transferata e deleguar; transferata e kushtëzuar e ML apo FZHSH etj. Shifrat i referohen faktit të realizuar përgjatë vitit kalendarik. | Buxheti     | mijë lekë        |      |     |       |   |
| 511  | Realizimi faktik i të ardhurave të veta të bashkisë                        | Totali i realizimit faktit të të ardhurave të bashkisë nga burimet e veta taksat, tarifat, të ardhura dytësore, donacione etj.  | Të ardhurat | mijë lekë        |      |     |       |   |
| 119  | Totali i të ardhurave të veta të bashkisë (plani i rishikuar vjetor)       | Totali i planit të rishikuar vjetor të të ardhurave të veta të bashkisë nga taksat, tarifat, të ardhura dytësore, të ardhura nga aktiviteti ekonomik, gjoha etj si edhe të ardhura nga donacionet: Periudha 1.1. viti (t) deri 31.12 viti (t)                                     | Të ardhurat | mijë lekë        |      |     |       |   |
| 509  | Te ardhurat e përgjithshme të bashkisë (realizimi faktik vjetor)           | Totali i realizimit faktit të të ardhurave të bashkisë nga të gjitha burimet e financimit (taksat, tarifat, dytesore, transferatat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara të qeverisë, donacione, etj. për vitin (t))   | Të ardhurat | mijë lekë        |      |     |       |   |

| KODI | F DHËNA   | PËRSHKRIMI   | SHËRBIIMI       | NJËSIA MATËSE | FAKT | VLERA |     |   |
|------|---|--|-----------------|---------------|------|-------|-----|---|
|      |   |  |                 |               | t-n  | t-2   | t-1 | t |
| 127  | Totali i shpenzimeve të përgjithshme të bashkisë (plani i rishikuar vjetor) | Totali i shpenzimeve të bashkisë nga të gjitha burimet e financimit: të ardhurat e veta; hua; granti pakushtëzuar; transferta specifike; transferta e deleguar; transferta e kushtëzuar e ML apo FZHSH etj. Shifrat i referohen planit të rishikuar përgjatë vitit kalendarrik (t) | Shpenzimet      | mijë_ lekë    |      |       |     |   |
| 24   | Totali i shpenzimeve kapitale të bashkisë (realizimi faktik)                | Totali i shpenzimeve kapitale që realizon bashkia nga të gjitha burimet e financimit: të ardhurat e veta; transferta të qeverisë të të gjitha formave; hua; donacione etj.(realizimi faktik) viti (t)  | Investimet      | mijë_ lekë    |      |       |     |   |
| 184  | Totali i shpenzimeve kapitale të bashkisë (plani vjetor)                    | Totali i shpenzimeve kapitale nga të gjitha burimet e financimit: të ardhurat e veta; transferta të qeverisë të të gjitha formave; hua; donacione etj. Shifra i referohet planit të periudhës të rishikuar gjatë vitit dhe miratuar në KB  | Investimet      | mijë_ lekë    |      |       |     |   |
| 184  | Totali i shpenzimeve kapitale e me financim të huaj (plani)                 | Plani total i shpenzimeve kapitale me financim të huaj si: pjesë e projekteve të donatorëve; hua në tregjet ndërkombëtare etj.   | Investimet      | mijë_ lekë    |      |       |     |   |
| 291  | Totali i huasë afatgjatë  | Totali i huasë afatgjatë që merr bashkia në një vit. Konsiderohet hua afatgjatë një maturim më i madhë sesa 12 muajt. Kujdes jo stoku i borxhit afatgjatë (i cili përfshin hua të marra në vitet e mëparshme deri në vitin korent).  | Risku financiar | mijë_ lekë    |      |       |     |   |
| 507  | Detyrimet financiarë të papaguara në kohë ndaj të tretëve                   | Totali i detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj personave të tretë ku përfshihen fatura të grumbulluara (dorezuar në bashki) por të papaguara nga bashkia për shërbimet e marra për më shumë sesa 30 ditë nga momenti i lëshimit (dërguar bashkisë për pagesë)            | Risku financiar | mijë_ lekë    |      |       |     |   |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E QEVERISJES SË MIRË**

| KODI | E DHËNA   | PËRSHKRIMI   | SHËRBIMI                       | NJËSIA MATËSE | FAKT |     | VLERA |   |
|------|---|--|--------------------------------|---------------|------|-----|-------|---|
|      |   |  |                                |               | t-1  | t-2 | t-1   | t |
| 85   | Numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar online në faqen e internetit të bashkisë | Numri i vendimeve të marra nga organet vendimmarrëse të bashkisë që janë të publikuara dhe janë të aksesueshme për publikun në faqen e internetit të bashkisë  | Transparenca dhe llogaridhënia | numër         |      |     |       |   |
| 301  | Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak   | Numri total të akteve të miratuara nga bashkia gjatë vitit të raportimit   | Transparenca dhe llogaridhënia | numër         |      |     |       |   |
| 92   | Numri i projektakteve të konsultuara për të cilat kërkohet me ligji konsultimi publik         | Numri i projektakteve për të cilat ligjet specifike sektoriale që lidhet me projekt aktin përcakton se duhet kryer konsultim publik para marrjes së vendimit, për të cilat bashkia ka kryer konsultim publik | Pjesëmarrja                    | numër         |      |     |       |   |
| 117  | Numri i projektakteve për të cilat kërkohet konsultim publik nga ligji specifik sektorial     | Numri i projektakteve për të cilat kërkohet konsultim publik nga ligji specifik sektorial që lidhet me projektaktin, sipas listës së bazës ligjore ku konsultimi eshte i detyrueshem                         | Pjesëmarrja                    | numër         |      |     |       |   |

|     |   |   |                 |       |  |  |  |  |
|-----|---|---|-----------------|-------|--|--|--|--|
| 316 | Numri i grave në organet drejtuese të bashkisë  | Numri i grave që mbajnë pozicione Kryetare Bashkie, Nën Kryetare Bashkie, Drejtorë Kabineti, Sekretare e Përgjithshme, Drejtorë Departamenti, Drejtorë e Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorë Drejtorie, Drejtuese e Njesisë Administrative, Shef Sektori.  | Barazia Gjimore | numër |  |  |  |  |
| 321 | Numri total i pozicioneve drejtuese të bashkisë | Numri total i pozicioneve drejtuese sipas organikes/struktures organizative të miratuar të bashkisë në vitin e raportimit. Pozicionet drejtuese janë Kryetar/e Bashkie, Nën Kryetar/e Bashkie, Drejtor/e Kabineti, Sekretar/e i/e Përgjithshëm, Drejtor/e Departamenti, Drejtor/e i Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtor/e Drejtorie, Drejtues/e i Njesisë Administrative, Shef Sektori. | Barazia Gjimore | numër |  |  |  |  |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E MBROJTJES NGA ZJARRI**

| KODI  | E DHËNA  | PËRSHKRIMI  | NJËSIA MATËSE | FAKT |     |     |   | VLERA |     |     |   |
|-------|--|---|---------------|------|-----|-----|---|-------|-----|-----|---|
|       |  |   |               | t-n  | t-2 | t-1 | t | t-n   | t-2 | t-1 | t |
| 549   | Zjarrëfiks në dispozicion  | Numri total i punonjësve të MZSH në bashki  | numër         |      |     |     |   |       |     |     |   |
| 290   | Numri i makinave zjarrfikëse në punë   | Numri total i automjeteve teknike – zjarrëfiksë të cilat janë në punë / në përdorim nga MSH për shuarjen e zjarrit                    | numër         |      |     |     |   |       |     |     |   |
| 363   | Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga MZSH (viti t)   | Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga struktura teknike e bashkisë/MZSH përgjatë gjithë vitit korent (ose t-1) | numër         |      |     |     |   |       |     |     |   |
| 363t1 | Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga MZSH (viti t-1) | Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga struktura teknike e bashkisë/MZSH përgjatë gjithë vitit korent (ose t)   | numër         |      |     |     |   |       |     |     |   |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E MENAXHIMIT TË MBETJEVE**

**FAKT**

**VLERA**

| KODI | EMËRI   | PERSHKRIMI  | SIKURIZIMI | UNITETI   | VLERA | UNITETI |
|------|---|---|------------|-----------|-------|---------|
| 338  | Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbim                 | Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbeqjeve sipas vlerësimit të sektorit teknik që përgjigjet për ofrimin e shërbimit.                         |            | numër     |       |         |
| 503  | Të ardhurat nga tarifa e shërbimit të mbeqjeve                    | Totali i të ardhurave nga tarifa e grumbulluar nga bashkia për shërbimin e menaxhimit të mbeqjeve   |            | mijë lekë |       |         |
| 37   | Total shpenzime për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeqjeve | Buxheti total për shërbimin e menaxhimit të mbeqjeve ku përfshihen shpenzimet e personelit të strukturës përkatëse që ofron shërbimin, shpenzime operative dhe kapitale për të. |            | mijë lekë |       |         |
| 388  | Sasia totale e mbeqjeve urbane                                    | Sasia totale e mbeqjeve urbane të grumbulluara dhe transportuara nga kazanat, koshat eij dhe depozituara në pikën fundore të mbeqjeve të ngurta urbane në gjithë bashkinë       |            | ton       |       |         |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E UJTJES DHE KULLIMIT**

| KODI | EMËRI                                      | PËRSHKRIMI  | MËSIA MATËSE | FAKT |     | VLERA |   |
|------|--|---|--------------|------|-----|-------|---|
|      |  |   |              | t-n  | t-2 | t-1   | t |
| 106  | Rijet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km  | Gjatësia totale në kilometër linear e kanaleve ujitëse që janë nën administrimin e bashkisë që është mirëmbajtur dhe/ose pastruar gjatë vitit të raportimit.  | km           |      |     |       |   |
| 107  | Rijet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km | Gjatësia totale në kilometër linear e kanaleve kulluese që janë nën administrimin e bashkisë që është mirëmbajtur dhe/ose pastruar gjatë vitit të raportimit. | km           |      |     |       |   |

|     |  |   |    |  |  |  |  |
|-----|--|---|----|--|--|--|--|
| 480 | Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km                         | Gjatësia totale e kanaleve ujitëse që i janë transferuar dhe administrohen nga bashkia sipas VKM përkatëse    | km |  |  |  |  |
| 478 | Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total Km                           | Gjatësia totale e kanaleve kulluese që i janë transferuar dhe administrohen nga bashkia sipas VKM përkatëse   | km |  |  |  |  |
| 986 | Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës dhe kullues (në Ha) | Totali i sipërfaqeve të zonave të caktuara gjeografike, që përfshijnë prej një sistemi ujitje dhe/ose kullimi | ha |  |  |  |  |

**LISTA E MATJEVE PËR TË DHËNAT E PYJEVE DHE KULLOTAVE**

| KODI | E DHËNA   | PËRSHKRIMI   | NJËSIA MATESE | FAKT |     |     |   |  |
|------|---|--|---------------|------|-----|-----|---|--|
|      |   |  |               | t-n  | t-2 | t-1 | t |  |
| 335  | Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullisor e mbuluar me plane mbarështimi (në ha) | Sipërfaqja pyjore për të cilën bashkia ka hartuar plane mbarështimi. Planet e mbarështimit janë dokumente bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmbajnë analizën e gjendjes së pyjeve, përcaktojnë objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikojnë masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme | ha            |      |     |     |   |  |
| 459  | Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullisor (në ha)                          | Sipërfaqja pyjore dhe kullimore brenda kufijve territorialë administrativë të bashkisë, transferuar sipas VKM përkatëse dhe është përgjegjëse për administrimin e fondit publik  | ha            |      |     |     |   |  |

|     |  |  |       |  |  |  |
|-----|--|--|-------|--|--|--|
